

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**NGA PRITJA SOLEMNE NË KUVENDIN E KOSOVËS ME RASTIN E VIZITËS NË
KOSOVË TË KONGRESISTIT AMERIKAN
ELIOT ENGELL MË 7 KORRIK 2005**

**SA SVEČANOŠ DOČEKA U SKUPŠTINI KOSOVA PRILIKOM
POSETE KOSOVU AMERIČKOG KONGRESMENA
ELIOTA ENGELA DANA 07. JULA 2005. GODINE**

**Korrik – Juli
2005**

T R A N S K R I P T

**NGA PRITJA SOLEMNE NË KUVENDIN E KOSOVËS ME RASTIN E VIZITËS NË
KOSOVË TË KONGRESISTIT AMERIKAN ELIOT ENGELL
MË 7 KORRIK 2005**

Pritja u organizua në Sallën solemne të Kuvendit të Kosovës, në orën 13,00.

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS NEXHAT DACI:

I nderuari dhe shumë i respektuar Kongresmen Engell,
Zoti President Rugova,
Kryetar i NAK-ut zoti Shkreli,
Të nderuar deputetë,

Ju premtova se pas sesionit të gjatë dhe të lodhshëm, në fund do ta kemi një freski të këndshme sepse mysafir në Kosovë është miku i vjetër i Kosovës, një kontributor i ditëve të vështira të nxënies së frymëmarrjes së Kosovës, atëherë kur paraqiste vizion të qartë për liri e demokraci për një popull të vogël në Ballkan.

Në shenjë të respektit të kontributit të tij – të Kongresmenit Engell që është mysafir i Parlamentit, dhe në shenjë të shumë kongresistëve e senatorëve tjerë amerikan, unë besoj se me vizionin dhe me fjalën e tij ai do t'na freskojë dhe do t'na udhërefojë neve në këtë Parlament.

Foltorja është e juaja, i nderuari Kongresmen. Urdhëroni.

KONGRESMENI ELIOT ENGELL:

(Transkriptohet nga përkthyesi simultan në gjuhën anglisht-shqip)

Ju faleminderit shumë! Zotëri Kryetar, nuk ndonjë fjalim të përgatitur, sepse dua të flas nga zemra. Nëse ka ndonjë gjë që di, gjatë 17 vjetëve sa kam punuar si Kongresmen Amerikan ajo është për luftën e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Derisa hyja në këtë objekt të bukur sot dhe në zyrën e Kryetarit dhe derisa ecja në korridor dhe tani para jush në këtë sallë – mund të them me siguri dhe me plotë bindje se ky është Parlament i një kombi të lirë dhe të pavarur.

(Duartrokitje frenetike)

Dhe sikur që ne kemi ardhë sot këtu, mund t'ju them me plotë bindje dhe siguri se shumë shpejtë Kosova do të jetë e pavarur dhe e lirë.

(Duartrokitje)

Dhe, kur të vijë ajo ditë, unë do të kthehem këtu në Prishtinë për të festuar me të gjithë ju lindjen e një kombi të lirë. Derisa unë jam rritur në Nju-Jork, kemi mësuar shumë për lindjen e kombit Amerikan, për njerëz sikur Gjorgj Uashingtoni, Tomas Pein, Gjejms Menrou, Tomas Medison – të gjithë këta janë njerëz për të cilët mëson secili fëmijë amerikan. Asnjëri prej nesh nuk ka jetuar para 200 vjetëve, sepse fatkeqësisht nuk jetojmë aq gjatë. Mirëpo, e di një gjë këtu, derisa ju shikoj, derisa shikoj përreth: Gjorgj Uashingtoni ishte Kryetar i parë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ibrahim Rugova është Kryetar i parë i kombit të Kosovës.

(Duartrokitje frenetike)

Dhe emrat tjerë që i kam përmendur për historinë amerikane, dikur edhe fëmijët shqiptarë do të mësojnë për këta emra, do të mësojnë për emrin e Kosumit, Dacit, do të lexojnë për të

gjithë patriotët tjerë të cilët kanë luftuar aq gjatë për të pasur liri, për të sjell liri. Dhe, mund të themi se ne kemi qenë dëshmitarë, kemi jetuar në kohën kur kanë ndodhë këto ndryshime.

Miqtë të mi, dua t'ju them se ndjehem shumë i nderuar që jam këtu. Para gjashtë vjetëve, kur isha këtu për herë të fundit – kam parë vdekje dhe shkatërrim. Kam parë shtëpi të djegura, kam parë zhgënjim, kam parë njerëz duke bërë titur, duke kërkuar ndihmë. Tani, pas gjashtë vjetëve, nuk i shoh më këto gjëra. Në të kundërtën – e shoh shpresën, ardhmërinë, shoh jetë, shoh se njerëzit kuptojnë se kanë një të ardhme. Vendi duket shumë më mirë, njerëzit duken shumë më të lumtur, dimë se ka ende punë për të bërë dhe e dimë se nuk do të jetë lehtë. E dimë se pas pavarësisë puna vetëm sa do të shtohet, vetëm sa do të fillojnë punët e rënda. Mirëpo, një gjë mund t'ua them: me siguri ardhmëria e këtij vendi është shumë e ndritshme dhe ajo është e tillë sepse ju të gjithë e keni mundësuar këtë.

Sapo jam kthyer nga Shqipëria, ku kemi qenë dëshmitarë të zgjedhjeve. Për shumë vite kjo pjesë e botës nuk ka qenë e lirë. Zgjedhjet e lira nuk kanë mund të mbahen. Njerëzit kanë qenë të burgosur, madje edhe vrarë sepse kanë rezistuar tiraninë. Në ndërkohë, të dielën e kaluar në Shqipëri, numër rekord i qytetarëve kishin dalë në votime, duke thënë se: dua të jam i lirë, dua të kam të drejtë të zgjedh liderët, dua të kam të drejtën sikur edhe të tjerët, që ardhmëria e vendit tim të shkojë në përputhje me parimet demokratike. Dhe ajo çka ka ndodhur të dielën në Shqipëri është e njëjtë sikur që duan kosovarët, që të zgjedhni udhëheqësit tuaj. Dhe e di se nuk i përkisni të gjithë partisë së njëjtë, ka shumë mospajtime ndoshta, por kjo është domethënia e demokracisë. Ajo për çka jam mirënjohës është se unë mund të shkoj në Uashington – në parlamentin tonë dhe mund të përlehem, mund të luftoj dhe sillem gati si i çmendur me kolegët e mi të cilët gjenden në taborin tjetër. Mirëpo, kur dal prej asaj salle mund të shkoj në restaurant e të pi apo të ha së bashku me ta. Sepse, edhe nëse mund të kemi opinione të ndryshme, ide të ndryshme – të gjithë punojmë për qëllime të njëjta. Ajo është ardhmëri më e mirë për popullin tonë, për fëmijët tanë, për një botë më të mirë. Dhe këtë ia dëshiroj edhe popullit të Kosovës.

Njerëzit shpesh më thonë: kë e favorizon në këto zgjedhje në cilindo shtet, dhe kur them se nuk anoj, sepse ky nuk është rol imi. Rol imi është që të nxisë miqësi në mes shtetit tim dhe shteteve tjera.

Dhe mund t'ju them se, kur bëhet fjalë për popullin e Kosovës, populli i Kosovës ka vend të posaçëm në zemrën time.

Ka disa gjëra në jetë kur të jesh i shtyrë në moshë, largohesh dhe i shikon gjërat nga distanca. Sot e kam djalin tim me veti... Gjon – ngrihu në këmbë që të shohin miqtë tanë.

(Duartrokitje ferenetike)

Ai më ka dëgjuar, kur flitnim për Kosovën gjatë të gjitha atyre vjetëve. Për këtë arsye, pata dëshirë që ai të vjen këtu dhe vetë ta përjetojë se çfarë do të thotë të jesh këtu në një kohë kur lind kombi. Ka shumë rrugëtime të vështira, ardhmëri që vështirë hapen. Populli i Kosovës, dua të siguroj, dhe të gjithë ata që jetojnë në Kosovë kanë të drejta. Kjo donë të thotë pakicat – të gjitha pakicat dhe gjithë qytetarët e Kosovës duhet t'i gëzojnë të drejtat e njëjta – për demokraci dhe liri. Kjo vlen për secilin shtet. Dhe populli i Kosovës, që i është nënshtruar tiranisë dhe shtypjes, e din se çfarë donë to thotë tirania dhe shtypja. Kjo është arsyeja pse është me rëndësi të sigurohen të drejtat e pakicave.

Mirëpo, në demokraci garantohen të gjitha të drejtat. Në demokraci mbizotëron shumica, por pakica i ruan të drejtat dhe mundësinë për ta njohur atë. Kjo është domethënia e demokracisë.

Edhe në vendin tonë kemi pas zgjedhje të vështira, ka pas konteste për zgjedhje presidenciale në vitin 2000, ka pas shumë të atillë që kanë menduar se personi i gabuar ka fituar apo ai që ka fituar në të vërtetë nuk ka fituar. Ka pas lloj-lloj konteste, por ajo që dallon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është se kur janë caktuar zgjedhjet, kur është marrë vendimi – nuk ka pas as tanke, as ushtarë në rrugë të nesërmen. Në demokraci ka rregulla, ligje, ka sundim të ligjit, ka gjykata dhe ato duhet të respektohen.

Unë kam pas fatin që kam jetuar në Nju-Jork – në Bronx dhe para 30 vjetëve shumë shqiptarë në Amerikë vinin prej Kosovës. Atëherë kam mësuar nga dora e parë se çfarë po ndodhë në këtë pjesë të botës. E kam një mik të mirin timin që është sot me mua, që ka ardhur në Zyrën time para 17 vjetëve dhe atëherë ai nuk më ka njohur, por më ka thënë: Duhet t'i ndihmoni popullit të Kosovës! Dhe prej asaj kohe kemi qenë partnerë për të përmbushur të njëjtin qëllim. Dhe, do të doja që edhe ai tash të ngrihet në këmbë.

(Duartrokitje)

Hari, është djalë i Kosovës, i lindur në Kosovë. Por e ka përjetuar ëndrrën amerikane. Familja je tij ka ardhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pa asgjë, pos në veshmbathje. Dhe, përmjet punës së tij të vështirë, dhe me pak fat – ka përjetuar shumë suksese. Kështu që, e kemi të ashtuquajturën ëndrrën amerikane, e unë dua të jam pjesë e ëndrrës Kosovare. Dua fëmijët e Kosovës të kenë mundësi të njëjtë, të kenë ardhmëri të shkëlqyeshme në vendin e tyre, ashtu sikur Hari dhe shumë të tjerë që kanë ardhur në SHBA duke kërkuar lirinë, mundësinë ekonomike dhe jetën më të mirë për vete dhe familjen e tyre. Ata kanë pas këso mundësi. Dua të gjithë fëmijët e Kosovës të kenë mundësi të njëjta, pa marrë parasysh a janë fëmijë shqiptarë, serbë, apo romë – çfarëdo të jenë – dua të gjithë fëmijët e këtij vendi të kenë liri dhe jetë më të mirë. Besoj se mënyra e vetme që të ndodhë kjo është nëse Kosova bëhet komb i lirë dhe i pavarur dhe sa më shpejt që të ndodhë kjo aq më mirë do të jetë.

(Duartrokitje)

Për shumë vite, shumë prej juve liderëve ka ardhë në Uashington. Doktor Rugova ka ardhur para Kongresit Amerikan – ka dëshmuar dhe treguar se çka po ndodh në Kosovë.

(Në mungesë të incizimit – përkthehet dhe transkriptohet nga përkthimi simultan anglisht-serbisht - në shqip)

Ju këtë e keni di ditur edhe nga televizioni, por këtë vetë nuk e përjetoni. Doktor Rugova dhe të tjerët të cilët kanë ardhë më kanë mësuar mua dhe kolegët e mi çka po ngjet dhe për çka në të vërtetë është fjala. Prandaj, sot unë jam këtu të flas me ju dhe unë kam nderin që mund të flas me ju, dhe sikur Kosova gjatë shumë viteve ka ardhur në Uashington që t'i drejtohet Parlamentit tonë – tani unë jam tani këtu që t'i drejtohem Kuvendit tuaj. Çdonjëri në këtë sallë është patriot. Secili në këtë hapësirë punon për të mirën e Kosovës.

Edhe një herë të them, ndoshta ekzistojnë mendime të ndryshme, por demokracia mund ta ketë edhe mënyrën e tillë. Mbrëmë patëm të organizuar një darkë. Në atë darkë unë thash – ka njerëz këtu që janë ulur pranë kësaj tavoline, por vetëm para disa vjetëve as që kanë folë ndërveti, e lëre më të ulen së bashku. Por, kjo ajo kur ka përparim në kuptim të demokracisë dhe për këtë aq shumë mendoj se së shpejti – dhe shumë shpejt Kosova do të jetë e lirë dhe vend i pavarur.

Unë iu thash shokëve të mi nga UNMIK-u dhe miqve të mi në vende tjera, se gjendja e tillë nuk mund të vazhdohet. Unë nuk kam ardhur deri në konkludim që Kosova duhet të jetë e

pavarur gjatë natës. Nëse shikoni të kuptoni çfarë është mundësia më e mirë për këtë vend, do të shihni se ekzistojnë vetëm disa mundësi, kurse njëra që do të ketë sukses – është pavarësia.

Lidhjet me Beogradin, sipas mendimit tim, nuk do të jenë më kurrë të nivelit të mëparshëm. Kur është fjala në kuptimin se Beogradi mund ta qeverisë Kosovën, kjo ka qenë, kjo ka kaluar, dhe ka marrë fund. Sikur të kishte udhëheqësi më të mirë atje, ndoshta do të ishte ndryshe, por nuk mund më të kthehet më “fantazma në shishe”. Do të thotë, kjo nuk do të jetë më opsion. Sipas mendimit tim, sa më parë politikajt dhe përfaqësuesit e zgjedhur në Beograd të fillojnë t’i flasin popullit të vet të vërtetën dhe t’i dhënë fund premtimit se ndoshta do të kthehet koha e tyre sikur pas njëzet vjetëve, do të bëhet ndryshe. Sa më parë t’i thonë popullit të vet të vërtetën, aq më parë edhe Serbia po ashtu do të jetë e radhitur si pjesë e lidhjes së popujve demokratë. Njerëzit duhet t’i thonë popullit të vet të vërtetën. Ndoshta dikush mund të thotë: mund ju këtu t’i mbani me shekuj ushtritë e huaja, mund Kosova të jetë nën protektoratin ndërkombëtar kohë të gjatë! Por, kjo nuk funksionon. Njerëzit e Kosovës, të rinjtë duhet të dinë se Kosova ka ardhmërinë, dhe ardhmëria e vetme e cila duhet të jetë – është që qytetarët e Kosovës me vetveten të qeverisin. Prandaj, mund t’i themi UNMIK-ut dhe kujtdo që i merr këto vendime, se duhet ta shpejtojë procesin.

Unë e di që ekziston përmbushje e standardeve, se do të ketë raporte dhe nganjëherë edhe frustrimet me burokracinë, por duhet t’iu mundësojmë dhe lejojmë qytetarëve të Kosovës që vetë të qeverisin me ministritë. Duhet t’iu lejojmë qytetarëve të Kosovës të udhëheqin dhe qeverisin me jetën e tyre.

Mbrëmë derisa udhëtoja dhe shihja fusha të mira dhe tokë të mirë pjellore, thoshte mendja se Kosova duhet të jetë prodhues i madh bujqësor, dhe të mos jetë importues por eksportues i prodhimeve bujqësore. Shumë çështje duhet të jenë të zgjidhura drejt në këtë vend - nëse është e pavarur, dhe nëse paraqet kërkesa për huat për zhvillim ekonomik. Nuk ka asgjë tjetër kuptim, asgjë tjetër nuk ka sukses - përveç pavarësisë. Asgjë tjetër nuk ka ardhmëri, përveç pavarësisë dhe kjo është mënyra se si njerëzit - në gjithë botën – e dëshirojnë pavarësinë.

Edhe qytetarët e Kosovës nuk kanë mendim tjetër. Dikush ndoshta do të thoshte – është bërë gabim, e kam fjalën për ish Jugosllavinë, ka qenë gabim që ai vend është shpërbërë. Unë po them, është e pamundshme “fantazmën ta ktheni prapë në shishe”. Por, e di një gjë: nëse tri të katërtat e qytetarëve të ish-Jugosllavisë kanë të drejtë të vendosin për ardhmërinë e vet dhe të formojnë shtetin e vet, atëherë shumë besoj se edhe kjo dy e katërta e ish-Jugosllavisë duhet ta ketë të njëjtën të drejtë, do të thotë edhe qytetarët e Kosovës.

Unë po ashtu mund të them me plotë besim - se kjo ka të bëjë edhe me qytetarët e Malëzisë. Unë mendoj se të gjithë njerëzit, dhe të gjithë popujt tjerë - kanë të drejtë në vetëvendosje. Po kështu, as qytetarët e Kosovës nuk dua të trajtohen ndryshe, apo në mënyrë tjetër nga njerëzit që kanë dëshirë dhe aspirata për ardhmëri, për liri dhe për pavarësi.

(Duartrokitje)

Më lejoni ta përmbyll këtë bisedë, ashtu sikur edhe e fillova. Po ju them se pata privilegje dhe nder që edhe një herë të jam këtu. Dhe do t’ju them që ky vend, secilën herë që vij, duket mirë e më mirë. Dhe, dy vendet tona – Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republika e Kosovës - që do të jetë, do të punojnë së bashku dhe do të jenë miq – miq të fortë dhe bashkëpunëtor, dhe se do të kenë ardhmëri të mirë në punën e përbashkët.

Kur udhëtoj nëpër botë, ka reaksione të shumta që i marrë si Kongresmen amerikan, por dua t’ju them se nuk ka vend ku ndjej më shumë ngrohtësi, se nuk ka vend ku më shumë ndjej që

jam i pritur më mirë, nuk ka vend tjetër ku amerikanët janë më të mirëseardhur - por vetëm në Prishtinë, dhe këtu në Kosovë. Amerikanët dhe qytetarët e Kosovës janë miq të mirë dhe do të jenë miq edhe më të mirë në të ardhmen sidomos kur të dy vendet tona të jenë të pavarura dhe të lira.

Faleminderit! Faleminderit! Zoti ju bekoftë dhe zoti e bekoftë Kosovën.

(Duartrokitje të pandalshme)